



: albansk

Informasjon om Dublin-regelverket



# CILI SHTET DO TË SHQYRTOJË APLIKIMIN TUAJ PËR AZIL?

INFORMACIONE MBI RREGULLOREN E DUBLINIT

## NË KËTË BROSHURË JU DO TË GJENI PËRGJIGJE PËR PYETJET E MËPOSHTME:

- Çfarë është Rregullorja e Dublinit?
- Cili shtet do të shqyrtojë aplikimin tuaj për azil?
- Çfarë ndodh nëse aplikimi juaj për azil mbulohet nga Rregullorja e Dublinit?
- Cili është qëllimi i Rregullores së Dublinit?

### 1. RREGULLORJA E DUBLINIT

- **Rregullorja e Dublinit** i është një marrëveshje e nënshkruar nga disa shtete evropiane në kryeqytetin irlandez Dublin.
- Jo të gjithë kanë të drejtë që aplikimi i tyre për azil të shqyrtohet në Norvegji. Kur aplikoni për azil, autoritetet norvegjeze vlerësojnë në fillim nëse plotësoni kushtet që çështja juaj të shqyrtohet në Norvegji. Ky proces mund të ketë dy përfundime: aplikimi juaj për azil do të shqyrtohet në Norvegji ose do të transferoheni në një shtet tjetër evropian, i cili do të jetë përgjegjës për aplikimin tuaj.
- Ka mjaft faktorë nga të cilët varet nëse aplikimi juaj do të shqyrtohet në Norvegji apo do të transferoheni në një shtet tjetër.
- Nëse aplikimi juaj për azil duhet të shqyrtohet në një shtet tjetër evropian, autoritetet norvegjeze nuk do të vlerësojnë arsyet tuaja për kërkimin e azilit, por vetëm se cili shtet tjetër evropian duhet të shqyrtojë aplikimin tuaj për azil.

### 2. CILI SHTET DO TË SHQYRTOJË APLIKIMIN TUAJ PËR AZIL?

#### **Aplikimi juaj do të shqyrtohet në një shtet tjetër nëse:**

- Keni aplikuar për azil në një shtet tjetër, të përfshirë në Rregulloren e Dublinit, para se të mbërrinit në Norvegji.
- Ju është lëshuar një vizë ose leje qëndrimi nga një shtet tjetër, i përfshirë në Rregulloren e Dublinit.
- Keni anëtarë të afërt të familjes në një shtet tjetër të përfshirë në Rregulloren e Dublinit.

- Keni udhëtuar ilegalisht në një shtet, të përfshirë në Rregulloren e Dublinit, të ndryshëm nga Norvegjia (ju janë marrë shenjat e gishtave).
- Keni qëndruar ilegalisht në një ose disa shtete, të përfshira në Rregulloren e Dublinit, për të paktën pesë muaj.

Nëse jeni nën 18 vjeç dhe nuk keni një prind ose kujdestar ligjor në Norvegji, aplikimi juaj për azil do të shqyrtohet në një shtet tjetër vetëm në rast se keni aplikuar për azil në shtetin tjetër në fjalë ose nëse keni atje prindërit ose kujdestarë të tjerë ligjorë.

### **Si vendosin autoritetet norvegjeze nëse aplikimi juaj do të shqyrtohet në një shtet tjetër?**

Mënyra më e zakonshme është kërkimi për shenjat e gishtave në Eurodac. Eurodac është një bazë të dhënash që përmban shenjat e gishtave të të gjithë personave mbi 14 vjeç, që kanë aplikuar për azil ose që kanë hyrë ilegalisht në një nga shtetet e përfshira në Rregulloren e Dublinit.

### **Aplikimi juaj mund të shqyrtohet sidoqoftë në Norvegji nëse:**

- Keni një vizë të lëshuar nga një shtet tjetër, i përfshirë në Rregulloren e Dublinit, që ka skaduar më shumë se gjashtë muaj më parë.
- Keni një leje qëndrimi të lëshuar nga një shtet tjetër, i përfshirë në Rregulloren e Dublinit, që ka skaduar më shumë se dy vjet më parë.
- Keni qenë jashtë shteteve, të përfshira në Rregulloren e Dublinit, për më shumë se tre muaj para se të aplikoni për azil në Norvegji. Ju duhet të vërtetoni vetë këtë gjë dhe kërkesat janë strikte. Biletat e udhëtimit dhe vula në pasaportën tuaj që vërteton se keni kaluar kufirin përkatës janë shpesh prova e vetme që pranohet. Drejtoria Norvegjeze e Imigracionit (UDI) do të vlerësojë sidoqoftë lloje të tjera të dokumenteve.
- Jeni kthyer në vendin tuaj të lindjes nga autoritetet në një shtet tjetër të përfshirë në Rregulloren e Dublinit.
- Keni një lidhje të ngushtë me Norvegjinë:
  - Keni anëtarë të afërt të familjes në Norvegji (bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijë nën 18 vjeç ose prindërit nëse jeni i mitur). Është e rëndësishme të informoni policinë norvegjeze lidhur me çdo familjar që mund të keni në Norvegji.
  - Keni mbajtur më parë një leje pune ose leje qëndrimi për më shumë se një vit në Norvegji.
- Autoritetet norvegjeze besojnë se çështja juaj duhet të shqyrtohet në Norvegji për arsye humanitare. Kjo mund të ndodhë nëse po kuroheni për një sëmundje të rëndë dhe/ose të rrezikshme për jetën dhe do të ishte e rrezikshme të ndërprisnit kurimin. Në raste të tilla, aplikimi juaj mund të shqyrtohet në Norvegji ose transferimi juaj mund të shtyhet deri sa të përmirësohet shëndeti juaj.

### 3. ÇFARË NDODH NËSE APLIKIMI JUAJ MBULOHEK NGA RREGULLORJA E DUBLINIT?

Këtu mund të lexoni se çfarë ndodh që nga momenti kur aplikoni për azil deri sa UDI vendos nëse aplikimi juaj do të shqyrtohet në Norvegji apo do të transferoheni në një shtet tjetër të përfshirë në Rregulloren e Dublinit:

- Kur aplikoni për azil, policia do të hetojë materialet, përfshirë pasaportën dhe vizën tuaj, dhe do të kërkojë për regjistrime të shenjave të gishtave tuaj në Eurodac.
- Nëse autoritetet norvegjeze besojnë se një shtet tjetër evropian është përgjegjës për aplikimin tuaj, atëherë ju nuk do të intervistoheni nga UDI.
- UDI do të kontaktojë me shtetin tjetër dhe do t'u kërkojë autoriteteve atje të marrin përgjegjësinë për çështjen tuaj.
- Ju do të informoheni me shkrim në rast se UDI i kërkon një shtet tjetër, të përfshirë në Rregulloren e Dublinit, që të marrë përgjegjësinë për aplikimin tuaj.
- Ju mund të kontaktoni me UDI me shkrim nëse keni informacione se pse aplikimi juaj duhet të shqyrtohet në Norvegji.
- Nëse shteti tjetër pranon përgjegjësinë, ju do të transferoheni atje.

#### Ju keni të drejtën e apelimit

Një avokat do t'ju informojë nëse UDI vendos se duhet të transferoheni në një shtet tjetër të përfshirë në Rregulloren e Dublinit. Ju keni të drejtë për ndihmë ligjore falas, në rast se dëshironi të apelon vendimin. Avokati duhet të paraqesë apelimin te UDI brenda tre javësh.

Si rregull, ju nuk do të lejoheni të qëndroni në Norvegji gjatë kohës së shqyrtimit të apelimit. Mos harroni se gjatë shqyrtimit të apelimit do të vlerësohet vetëm nëse aplikimi juaj për azil duhet të shqyrtohet në Norvegji – jo arsyet tuaja për aplikimin për azil. Meqenëse autoritetet norvegjeze nuk do t'ju kthejnë në vendin tuaj të lindjes, ato nuk do të vlerësojnë as nëse kjo gjë do të ishte e rrezikshme. Kjo është detyrë e shtetit përgjegjës, të përfshirë në Rregulloren e Dublinit, nëse nuk e ka kryer tashmë këtë proces.


#### Koha e shqyrtimit të çështjes

Normalisht duhen dy deri në gjashtë muaj që UDI të vendosë nëse çështja juaj do të shqyrtohet në Norvegji ose nëse do të transferoheni në një shtet tjetër, të përfshirë në Rregulloren e Dublinit.

### 4. CILI ËSHTË QËLLIMI I RREGULLORES SË DUBLINIT?

- Të parandalojë që i njëjti person të kërkojë azil në disa shtete në të njëjtën kohë ose në vijim.
- Të sigurojë të drejtën e azilkërkuetit që aplikimi i tij/saj të shqyrtohet në një shtet evropian. Kjo gjë shmang dërgimin e azilkërkuetit nga një shtet në një shtet tjetër kur asnjë nga këto shtete nuk merr përgjegjësi për azilkërkuetit.
- Të mbajë familjet e bashkuara në mënyrë që çështjet e anëtarëve të afërt të familjes (prindërit, fëmijët nën 18 vjeç, bashkëshortët, në disa raste partnerët/personat me të cilët bashkëjetojnë) të shqyrtohen nga i njëjti shtet.

## SHTETET EVROPIANE TË PËRFSHIRA NË RREGULLOREN E DUBLINIT:



1 Belgjika	7 Greqia	13 Lituania	19 Portugalia	25 Zvicra
2 Bullgaria	8 Irlanda	14 Luksemburgu	20 Rumania	26 Suedia
3 Danimarka	9 Islanda	15 Malta	21 Sllovakia	27 Republika Çeke
4 Estonia	10 Italia	16 Holanda	22 Sllovenia	28 Gjermania
5 Franca	11 Qipro	17 Norvegjia	23 Spanja	29 Hungaria
6 Finlanda	12 Letonia	18 Polonia	24 Mbretëria e Bashkuar	30 Austria

Kjo broshurë është përgatitur nga Organizata Norvegjeze për Azilkerkuesit (NOAS).  
NOAS është një organizatë joqeveritare për të drejtat e njeriut që siguron informacione dhe asistencë ligjore për azilkerkuesit.w

## ADRESAT

### NJËSIA E IMIGRACIONIT E POLICISË (POLITIETS UTLENDINGSENHET)

Policia regjistron azilkërkuesit e sapoardhur.

Policia riatdheson po ashtu azilkërkuesit që nuk largohen vullnetarisht nga Norvegjia, pasi u refuzohet aplikimi i tyre për azil.

**Adresa postare:** Postboks 8102 Dep., NO-0032 Oslo, Norway

**Adresa për vizita:** Christian Krohgs gate 32, 0186 Oslo

Tel.: +47 22 34 24 00, Faks: +47 22 34 24 80

Email: [pu@politiet.no](mailto:pu@politiet.no)

### DREJTORIA NORVEGJEZE E IMIGRACIONIT (UDI)

është një institucion qeveritar, detyrat e të cilit përfshijnë shqyrtimin e aplikimeve për azil, çështjet e vizave dhe të shtetësisë kombëtare dhe ribashkimin e familjeve. UDI është përgjegjëse edhe për qendrat e pritjes.

**Adresa postare:** Postboks 8108 Dep., NO-0032 Oslo, Norway

**Adresa për vizita:** Hausmannsgt. 21, 0182 Oslo

Tel.: +47 23 35 15 00, Faks: +47 23 35 15 01

Website: [www.udi.no](http://www.udi.no), Email: [ots@udi.no](mailto:ots@udi.no)

### ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE PËR IMIGRACIONIN (IOM)

Informacione për kthimin vullnetar të ndihmuar

**Adresa postare:** Postboks 8927 Youngstorget, NO-0028 Oslo, Norway

**Adresa për vizita:** Storgata 10a, 2nd floor, 0155 Oslo

Tel.: +47 23 10 53 20, Faks: +47 23 10 53 21

Email: [osloreturn@iom.int](mailto:osloreturn@iom.int)

Orari i punës: Ditë jave: 10:00 – 15:00, Fundjavë: Mbyllur

### **BORDI NORVEGJEZ I APELIMEVE TË IMIGRACIONIT (UTLENDINGSNEMNDA – UNE)**

është një organ administrativ gjysmë-gjyqësor që shqyrton apelimet në lidhje me refuzimet e bëra nga UDI.

**Adresa postare:** Postboks 8165 Dep., NO-0034 Oslo, Norway

**Adresa për vizita:** Stenersgt. 1B/C, 0050 Oslo

Tel.: +47 21 08 50 00, Faks: +47 21 08 50 01

Website: [www.une.no](http://www.une.no), Email: [postmottak@une.no](mailto:postmottak@une.no)

### **KRYQI I KUQ NORVEGJEZ (NORGES RØDE KORS),**

shërbime kërkimi, ndihmon për rivendosjen e kontakteve ndërmjet anëtarëve të familjes që janë ndarë për shkak të luftës, konflikteve ose katastrofave.


Kryqi i Kuq nuk i jep informacionet tuaja te UDI ose të tjerë. Shërbimi është falas.

**Adresa postare:** Postboks 1 Grønland, NO-0133 Oslo, Norway

**Adresa për vizita:** Hausmannsgt. 7, 0186 Oslo

Tel.: +47 22 05 40 00

Website: [www.rodekors.no](http://www.rodekors.no), Email: [tracing@redcross.no](mailto:tracing@redcross.no)



**Organizata Norvegjeze për Azilkerkuesit (NOAS)**

Adresa për vizita: Torggata 22, 0183 Oslo, Norway

Adresa postare: PO Box 8893 Youngstorget, NO-0028 Oslo, Norway

Tel.: +47 22 36 56 60, faks: +47 22 36 56 61

Website: [www.noas.org](http://www.noas.org), Email: [noas@noas.org](mailto:noas@noas.org)